

INTERVISTË ME HASAN ABAZIN

Prishtinë | Data: 17 nëntor, 2023

Kohëzgjatja: 123 minuta

Të pranishëm:

- Hasan Abazi (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Hasan, nëse mundeni me u prezentu, me na tregu diçka për vendin ku keni lind? Kur keni lind? Për kujtimet?

Hasan Abazi: Faleminderit! Unë jam Hasan Xhemajl Abazi i lindun në fshatin Davidovc komuna e Shtimës tash, atëherë ka qenë komuna e Ferizajit. Fëmijërinë time e kam fillu në fshat, shkollën fillore dhe tetë vjeçaren e kom kry në fshat edhe në Shtime. Ndërsa shkollën e mesme teknike e kom fillu në Ferizaj, gjenerata e parë.

Anita Susuri: Çfarë familje keni qenë ju?

Hasan Abazi: Kemi qenë ni familje mesatare ekonomikisht. Me traditë nga familja, gjyshi jem që emrin e mbajë unë Hasan, ka qenë organizator kundra reformës agrare në 1924-ten. Sëbashku me fshatarët e tjerë nga fshatrat e komunës së Shtimës dhe të Ferizajit kanë kundërshtuen marrjen e tokave për kolon n'atë kohë. Kështu që unë vazhdoj aktivitetin e gjyshit tim. Ma vonë baba, edhe pse ka qenë i pa shkollun, gjithnji ka pasë dëshirë që ne të shkollohemi. Për arsye se nga peripetitë që ka pasën ai n'atë kohë e ka kuptu që pa u shkollu nuk ka mundësi tjetër. Kështu që në ato mundësi tona ekonomike na ka mundësu që të shkollohemi.

Anita Susuri: A dini diçka ma shumë për këtë aktivitetin e gjyshit? A ka pasë ndonjë pasojë pastaj? A është përndjekë a?

Hasan Abazi: Po tanë kohën faktikisht familja jonë ka qenë e përndjekur prej pushtetit serbo-jugosllav n'atë kohë. Gjithnji kemi qenë në sytë e pushtetit. Faktikisht, tanë kohën kemi qenë t'vëzhgum, t'kontrollum. Babën tim, se gjyshi m'ka vdekën në '40-ten, pak para se me fillu Lufta e Dytë Botërore, kështu që aktiviteti tjetër i ka mbetë babës tim edhe normalisht edhe tjerve të cilët n'atë kohë kanë, kanë vazhdu aktivitetin.

Posaçërisht aktivitet të shtruar ka vazhdu mixha i jonë, Shqip Abazi. I cili gjatë asaj kohe në moshën e re '40-'45-ten ka bartë flamurin në tubimet e atëhershme për çashtjen e lirisë kombëtare. Po pas 1945-tes, babën tim e mobilizojnë dhe e dërgojnë për Tivar. Kështu që ai tan kohën na ka shpjegue për

masakrën e Tivarit. Ka pasë fatin me ni grup bashkëfshatarëve edhe ni pjesë të cilët kanë shpëtuen nga masakra e Tivarit dhe tërë kohën ai në odën tonë mysafirëve edhe miqve ju shpjegojke rreth çashtjes. Ni gja të tillë e kam dëgju edhe unë për arsye se isha i ri dhe isha kureshtar ta dijë atë historijen e hidhur të popullit tonë.

Anita Susuri: E përmendet për babën e juv që ka qenë domethonë atëherë osht' marrë prej forcave jugosllave n'atë kohë dhe është dërgu për Tivar, ka ndodhë masakra e Tivarit. Nëse mundeni me na tregu çka, çka ka tregu baba?

Hasan Abazi: Baba ka tregu se kanë qenë shtatë bataljona të mobilizun dhe kur kanë vazhduen rrugën për Prizren, në atë drejtimin e Shqipërisë, ka treguen që në bataljonin e tynen kanë qenën ni pjesë e rrethit të Prishtinës, të Ferizajit, të Lipjanit. E bataljanat tjerë kanë qenë bataljana nga Drenica edhe me kto veshjet kombëtare. Kështu që tregon, kur kanë shkue në Kalanë e Shkodrës, ni djalë i ri ju ka ofruen afër e ju ka thanën, "E mor' ju kosovar, nuk e dini çka osht' tu ju pritën". "Aty", tha, "na ka bo me dije".

Mirëpo këta kanë qenë të rrethekuar nga forcat e shumta edhe shqiptare edhe jugosllave. Çka osht' ma e keqja simbas deklaratës të babës. Pas një kohe i kanë depërtue në Tivar, thonte, te ni ndërtesë ku e kanë terë duhanin. Ai thonte depoja e duhanit. Kur kanë shku n'atë vend atëherë kanë vrejtë ni masakër që ish bo para tyne. Ndërkohë e rrethekojnë edhe niherë këtë bataljonin e babës dhe gjujnë me pushko-mitrolez përpjetë me qëllim që këta të ikin. Atëherë në ikje e sipër të bëjnë masakrën.

Mirëpo këta të gjithë kanë vendosën që aty mos me lujt nga vendi dhe thotë, "Kshtu edhe shpëtunëm". Ndërkohë ka ardhë ni gjeneral a epror ushtarak i Kroacisë dhe i ka marrën ai përpara këta mrapa dhe kanë vazhdu deri në Trijestë. Në Trijestë e kthim te knena n'këtë anë thotë, "Kemi psu shumë se njerëz të lodhur, pa bukë, pa ujë dhe shumicën e njerëzve kur kanë kërku ujë ose bukë nga forcat malazeze ka pasë masakër". Njeri që ka kërku ujë apo bukë faktikisht ma nuk osht' kthy në qetën e ktyne. Kshtu që saherë që shkojshum në pushim në Ulqin ai qajke në Tivar. Kjo osht' ni... edhe (qan)

Anita Susuri: A doni me pushu?

[Këtu ndërprehet intervista]

Hasan Abazi: Pas kthimi nga Triesta në shtëpi edhe pse në Shtime me rrethin kanë qenë vetëm 2% popullat serbe, tan administratën e kanë pasë serbët në atë kohë. Meniherë e kanë marrë, edhe pse, ata të cilët kanë qenë në front të luftës, se atëherë kanë thanë kshtu, p'e përcjellmi, p'e përzam gjermanin. E detyrojnë babën tim me shku ushtar në ushtinë jugosllave, dy vjet. Edhe pse s'kanë pasë të drejtë mirëpo administrata serbe këtë qasje, sa ma shumë të zbrazin numrin e njerëzve. Kështu që n'atë kohë, '47-ten linda une, djali i dytë i familjes të Xhemajlit edhe të nanës Hanumshah.

Anita Susuri: Sa fmi keni qenë ju?

Hasan Abazi: Faktikisht pesë fmi kemi qenë po tjetër kanë ndrru jetë vetëm kemi mbetë tre vllazën, Ahmeti, Hasani edhe Hyseni. Këta emra të cilët Hasani, Hyseni janë emra të cilët janë trashëgu nga gjyshërit, stëgjyshërit tonë përpara. Kshtu simbas asaj traditës janë përtri emrat e njerëzve. Kështu që me lindjen time faktikisht dërgojnë ni telegram për me mujtë me ardhë s'paku në shtëpi n'atë kohë shtatë ditë. Kjo përputhet tamon kshtu që ditëlindja ime e ka, osht' karakteristike që nuk ka ndryshim. Se ka raste që ma vonë e kanë shkru mas ni vjeti e tjerë. Kështu që kjo lidhet me babën tim në ushtri dhe telegramin për lindjen.

Anita Susuri: E baba tani ka ardhë veç në vizitë apo e kanë...

Hasan Abazi: Jo veç në vizitë, në vizitë shtatë ditëshe e tani ka vazhdu. Ajo çka osht' me randësi, faktikisht, unë në moshën nantë-dhjetë vjeçare na vdiq nana. Mbete vetëm jetim kshtu në aspektin e mbikqyrjes familjare. Si t'ri atëherë baba u detyru të martohet por ne faktikisht nga kushtet ekonomike tan kohën kemi flejtën në odën e miqve, si e kemi qujtë n'atë kohë. Tan kohën si fëmijë jam rritën edhe jam eduku në odën e miqve nga biseda të cilat janë ba në odë në atë kohë.

Pasiqë radio e televizion nuk ka pasën, bisedat kanë qenën... po edhe niherit jemi marrë edhe me kangë edhe me deklaratat e mixhës. Ai sesi i ka mësu n'atë kohë prej '40-tes deri '45-tes në shkollat me msusin Rexhep Shpendi në Shtime. Ai na ka msuen himnin e flamurit, ai na ka mësuen vjerrsha të ndryshme të cilat i ka recitu edhe n'tubimet e asaj kohe.

Faktikisht edhe ajo ishte ni pjesë e edukatës të cilët shtynjë që ta kuptojsh në peripeti të pushtetit të atëhershëm mas '45-tes që është bo në Kosovë. E posaqërisht me ndalimin e flamurit të gjithë ishin të brengosur se si m'u ndalu flamuri shqiptarë kur tanë kohën është luftu që t'jemi t'barabartë në atë kohë. Me vdekjen e nanës lindi edhe peripetia tjetër, koha e Rankoviqit rreth mbledhjes së armëve. Babën tim prej të gjithë të tjerëve, babën tim ma së shumti e kanë malltretue duke kërku pushkë.

M'kujtohet pak ditë para vdekjes t'nanës që nana e mbledhi ni copë bukë e pak kryp edhe ia shtini në xhepin e brendshëm edhe i thotë, "Buka e krypa të shpëton nga malltretimi". Këtu isha i vogël edhe duke e përcjellë babën që e pritshim se a do t'vjen i gjallë apo do t'vjen i vdekur faktikisht. Koha ishte e vështirë, koha ishte dimër. Bora e madhe, akull, ftoft. Këta për tri ditë e tri net e kanë malltretu në stacionin policor të Shtimës.

Mirëpo mixha u gjind disi e siguroj ni pushkë në Maqedoni dhe me atë e kaloj edhe baba këtë peripeti. Mirëpo nuk ishte rasti i pushkës, ni pushkë e hekurit e cila nuk i vyn askujt n'atë kohë. Ishte pikërisht peripetitë e gjyshit, domethonë, familja jonë që ishte në shiqim të pushtetit të asaj kohe. Baba im tregon edhe me peripetitë gjatë, se osht' marrë me bartjen e malltrave për Prizren.

Kështu që kur kanë shku në Caralevë, ka qenë në stacion i gjandarmërisë, policisë, aty tan kohën janë malltretu të gjithë ata qytetarë që kanë shku për Prizren. Se jo ti ke ngarku shumë e po mundon kafshët. Peripeti vetëm me mujtë me gjetë pretekst. Kështu që krejt kto ishin rrëfime të prindërve tonë që ne u brymosum si gjeneratë e re, pasardhësit e tyre.

Pak përpara thashë që ka pasë dëshirë të shkollohem, atëherë unë fillova shkollën e mesme teknike. gjenerata e parë jom në shkollën e mesme teknike në Ferizaj. U regjistru dy paralele, njëna në gjuhën serbo-kroate, njëna në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe diku u regjistru rreth 40 nxanës dhe në vitin e dytë kalum vetëm gjashtë. Kështu që edhe këtu u shihke pushteti i Rankoviqit për diskriminimin e bërë. Tan kohën na thojshin se ju nuk jeni për shkollë e posqërisht për këtë shkollën teknike. Ju jeni për me shku me mbjellë specat, domate edhe me punu tokën se ju nuk jeni për këtë lloj shkollimi.

Anita Susuri: E ju thatë që në Ferizaj e vazhdu atë shkollimin, a keni udhëtu a keni banu a qysh ka qenë kjo kohë?

Hasan Abazi: Kam udhëtu shumicën e rasteve kom udhëtue. Në ora tetë në mramje përfundojshin vonë, 12 kilometra kom udhëtu prej Ferizajit për fshatin Davidovc. Peripetitë kanë qenë t'mdhaja se rreth Gllavicës është në fshat ku aty kanë qenë të banun malazez. Kanë pasë qen të, kshu, të fshtirë dhe u dukë, u detyrojshim të hjekshim kpucat edhe pse s'kemi pasë kpuca po jemenijat n'atë kohë, vetëm e vetëm që mos të trokasim që t'na ngajnë qent. Se atëherë qent e tyre ishin kshu si rojë, gjoja se po e sulmon dikush fshatin e ktyne malazezëve.

Kështu që mas në kohe lindi në autobus që i thojshin lokal dhe në atë autobus... tani erdh edhe vllau i dytë, i vogli i imi Hyseni. Atëherë herë shkojshim me autobus edhe zunëm banesë kshu në Ferizaj. Por tanë kohën bukën e kemi marrë me veti për në javë ditë, për shkak t'kushteve të cilat kanë qenë. Unë arrita me shokë të diplomoj në shkollën e mesme teknike. Na gjashtë arritëm të diplomojmë edhe katër shokë erdhën nga Prishtina që kshu në shkollën teknike e kishin humbur vitin. U bonëm dhetë.

Në vitin e dytë na bashkunën me klasën serbe dhe tanë kohën në gjuhën serbo-kroate e kemi ndëgjju msimin. Edhe pse për neve ka qenë vështirësi për arsye se ne nuk e kemi njoftë gjuhën serbo kroate, se n'atë kohë ose në fshatin tim nuk ka pasën serb që t'mujnë të komunikojmë. Osht' me rëndësi të theksohet se në vitin 1966 ishim në vitin e katërt të shkollës teknike kur ra Rankoviqi. Atëherë filloj konflikti ndërmjet serbëve dhe neve shqiptarëve. Se ata e mbrojshin veprimet e Rankoviqit ndërsa na shqiptartë e mbrojshim aktivitetin dhe luftën e Emin Durakut, Fadil Hoxhës e tjerë.

Kështu që këtu lindi konflikti dhe nga ai konflikt kemi pasën peripeti shumë t'mdhaja nga pushteti jonë atëherë. Disa takime na mbyllen kabinetin e fizikës me qëllim që t'pajtohemi. Na nuk mujshim m'u pajtu me njerëz t'cilët e mbrojshin gjakatarin e popullit tonë, Rankoviqin. Kështu që e kemi pasë edhe konflikt fizik nërmjet veti. Por mua edhe në shokun, Hysen Muhaxherin, na dënunen. Në vend se se me

na shpërbly, na dënunen me notën e sjelljes nish. Unë n'fund t'vitit, kolektivi i shkollës murr vendim që t'na rregullon dënimin dhe na kshtu diplomunum.

Mirëpo tan kohën kto ishin ato peripetitë, ato mllfosjet të cilat i ndëgjojsim drejtpërdrejt në lëkurën tonë. Kjo ishte ajo të cilën edhe ne n'atë moshën tonë rinore u mundojsim se si t'dalmi nga gëzhoja e serbo sllavisë n'atë kohë. Mas diplomimit në shkollën e mesme teknike, fillum të regjistrohemi në fakultete dhe shkolla t'larta. Unë me ni koleg timin të ndjerë tash, Ismet Ramadanin, që e kishna edhe shok të gjeneratës, u regjistrunum në shkollën e lartë pedagogjike në Prizren, matematikë-fizikë. Kurse kolegët e tjerë, disa në shkolla e lartë aëtherë ishte në Prishtinë, dikush në Lublanë, dikush në Rijekë. Kështu që u shkep gjenerata e '66-'67-ten.

Ajo çka osht' me randësi ta ceki, ni knaqësi tash në mesin e krejt asajna, ishte loja Shqipëri, Jugosllavi-Shqipëri në Beograd. Dëshira e madhe e jona ishte, jo fort për lojë me pa, po ishte dëshira e madhe me shku me pa flamurin kur t'valon në Beograd. Kështu që e ndëgjnum, e ndëgjnum në Rilindje që, se atëherë disa lajme u cenzurojsin. Fillum të mbledhim t'holla. Secili u kthym në shpi dhe po kërkojmë se normalisht na s'kishim t'ardhura tjera përpos nga prindërit tonë.

U ktheva unë dhe babës fort nuk i lypshna mjete. Po ishte ardhën mixha nga Shkupi edhe i thom, "Mixhë bre, po m'vyn pak pare", "Pse?" Thashë, "Po dojmë me shku në për Beograd", "Qysh për Beograd?" Thashë, "Po luhet loja Jugosllavi-Shqipëri edhe atje valon flamuri". Atij ju mushën sytë lot. Ai i nxuri mjetet edhe ju mushën sytë lot edhe tha, "Urdhno shko", tha. Kështu që na shkunëm në Beograd po aty të gjithë kjo gjenerata jem e ma vonshme që janë marrë me demonstratat e '68-tes ishin pro flamurit.

Aty arritëm që të njihemi ndërmjet veti, e posaqërisht me Afrim Loxhën, [Skender Muçollin](#), Asllan Dumoshin që kishin ardhë nga Lublana me pa ndeshjen. Du t'ju tregoj se osht' shumë me randësi, gati Stadioni i Partizanit i mbushun gati muj me thanën që 70-80% kanë qenë shqiptarë të gjitha trojeve. Në ish Jugosllavi kuptohet se prej Shqipërisë atëherë s'besoj që i kanë leju për me ardhë në ndeshje. Kështu që ku u vrejke ajo, kur shkojke topi afër golës të pjesës Jugosllave, të gjithë stadioni buçitke. Faktikisht edhe aty ishte ni demostrim pa parolla. Ashtu e kom mendu unë.

Për herë t'parë Afrim Loxha në dorë ni amblemë të qendisur të flamurit ia dha Ismet Ramadanit, atij shokut. Se ata janë njoftë se nga gjenerata e parë në Prishtinë. Aty në prezencën e krejt shokve tha, "Unë", tha, "këtë amblemë që ma dhurove mu", tha, "unë do t'ja japë shokut tim Hasanit", edhe nga ai moment unë e kom pasë '67-ten e kom pasë amblemën e flamurit nga Afrim Loxha. Tash po e thom Afrim Loxha edhe pse e ka përcjellë përmes Ismet Ramadanit. Kështu që ishim t'knaqun që ishim pranë flamurit, s'ish me randësi fort se a hupi a fitoj kombëtarja shqiptare po ish...

Anita Susuri: A hupi a fitoj?

Hasan Abazi: Humbi, humbi, për fat t'keq humbi po megjithatë ishte ni knaqësi, ishte ni shirim shpirtnor i të gjithë njerëzve të cilët... merre me mend ka pasë edhe sharraxhi që kanë punue shqiptar në Beograd në prerjen e druve, ka pasë në atë ndeshje. Kështu që ka mbetë si kujtim edhe në kujtimet e mija të '68-tes. E kom shkru, thom, demonstrimin në Beograd pa parolla.

Anita Susuri: A ju kujtohet naj detaj prej ksaj për shembull? Qysh ka qenë qyteti ose ju në shoqni qysh jeni gjetë? Në qytet? Qysh keni shku? Ndonjë detaj nëse ju kujtohet?

Hasan Abazi: Zakonisht ne të gjeneratës, thojmë, t'parët të shkollës teknike u bonëm dhetë shokë. Qata dhetë shokë u takojshim herë në banesën time, herë në... se atëherë ka pasë pak kafiteri në Ferizaj. Faktikisht Hotel Luboteni ka qenë vend takimi i studentëve po edhe takime tjera miku me mik ose shoku me shok. Me pi ni kafe ose me bisedu ka qenë Hotel Luboteni. Kështu që në Hotel Luboten kemi pasë nifar kthese si n'formë të gjysmë rrumullakut. Aty ka qenë ni tavolinë e rrumbullakët dhe ajo tavollinë faktikisht ka qenë për neve studentëve.

Kamarietë gjatë shërbimet që na bojshin na thojshin, "Këta e kemi t'rujtun për juve, studentëve. Kjo është vendi juve". Edhe pse në pjesën tjetër kishte kangë, kangë kishte në gjuhën serbo-kroate, në gjuhë tjera që, pak në gjuhën shqipe. Po neve ma tepër na interesojke biseda ndërmjet shokve edhe situatës të cilës mbretërojke në atë kohë. Ferizaji nuk ka qenë kshtu i rregullun, ka pasë ni rrugë kryesore edhe ni rrugë dytësore. Pjesa tjetër ka qenë ndryshe nga kjo sot që shifet. Po kryesorja osht' se e ka, e ka pasë trenin.

Faktikisht më 1878-ten ajo osht' ndërtu hekurudha atëherë edhe Ferizaji në ni formë është kujtë edhe tasjan se osht' stacion. Kështu që në gjuhën e turqishte e tjera... edhe njerëzit kanë udhëtu me tren prej Ferizajit për Beograd, për Munich, për Shkup, për vende tjera. Kjo osht' me randësi se Ferizaji në momentin kur osht' vendosën treni ka fillu edhe zhvillimi ekonomik i Ferizajit. S'pari aty Shashivar Ferizi ka, Feriz Shashivari, e ka ba ni han ose ni formë bujtine dhe nga ajo, se aty s'ka pasë kshtu banim.

Banim ka pasë rreth Ferizajit po në Ferizaj n'atë kohë nuk ka pasë banim. Kështu që dal nga dalë duke ardhë njerëz për me udhëtu në kto drejtime kanë fillu edhe t'vendosen në qytetin e Ferizajit, sa unë kom njohuri, edhe pse gjenerata jeme osht' e vonë n'krahësim me themelimin e stacionit. Mirëpo nga të tjerët që kanë thanë se Ferizaji osht' zhvillu mbas vendosjes së stacionit të trenit në Ferizaj. Dy kafehane kanë qenë kshtu po njana ka qenë e rakijes, që ne si t'ri nuk kemi shku shumë në atë kafiteri. Kurse, në Hotel Luboten tan aktivitetin, ton bisedat, ton brengat edhe t'studimeve edhe të politikës i kemi rrehën, i kemi diskutu me shokë aty në atë vend.

Anita Susuri: E qysh ka qenë, në Ferizaj a ka pasë ndonjë jetë kulturore, shoqërore kshtu? Ndonjë aktivitet?

Hasan Abazi: Jeta kulturore në Ferizaj ka fillu të lulëzon mbas meje, mas ramjes së Rankoviqit. Mas vitit 1966-ten. Atëherë osht' themelue në 1967-ta osht' themelue Ansambli i Kangëve dhe Valleve Kastrioti në Ferizaj. Ardhja e ansambleve tjera e ka gjallërue në ni formë jetën në Ferizaj. Ka ekzistue edhe Shoqata e Shkrimtarëve De Rada në Ferizaj. Faktikisht jeta kulturore sa unë muj ta përceptoj osht' zhvillu me hov të madh në Ferizaj mas vitit 1967. Duke ju falënderu edhe disa intelektualëve në Ferizaj që krijun edhe Radio Ferizajin edhe njiherit edhe për informim edhe kto shoqatat të cilat u marrshin me çashtjen kulturore.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po du, domethonë, po i ofrohemi viteve '68 kur kanë qenë demonstratat. Ju veç fillut me m'tregu për shoqinë që keni kriju për bisedat, po nëse mundeni me na tregu qysh ka ardhë deri te ajo krejt? Organizimi?

Hasan Abazi: E keni fjalën për '68-ten?

Anita Susuri: Po, demonstratat.

Hasan Abazi: Atëherë ne u regjistrunëm në fakultet edhe në shkolla t'larta në Prishtinë, dikush në Shkup, dikush në Rijekë, sikur që e thashë pak ma parë. Ni pjesë e tyne me hapjen e Fakultetit Teknik atëherë na që ishim në Prizren erdhëm edhe u regjistrunum në Fakultetin Teknik. Ata që ishin në Lublanë e disa në pjesë tjera, faktikisht fillum në Fakultetin Teknik në '67-ten. Vijum studimet. Në vitin '68... edhe kshtuqë filloj të njihemi në mes veti, ta zgjenojmë shoqërinë si në Ferizaj me shoktë që i përmenda pak më parë.

Po aty nuk janë kanë vetëm të Shkollës Teknike, tash u zgjenu me përfaqësues të Shkollës Normale edhe shkollave tjera që ishin në Ferizaj. Kështu që u bom ni shoqni pak ma e gjanë në krahasim me atë grupin. Celula kryesore është grupi prej dhetë personave. Unë për shkak se vllau i vogël u regjistru në Fakultetin e Pylltarisë në Shkup, atëherë ishte barra pak e randë për familjen që me na mbajtë te dyve. U hap ni konkurs në termo elektranën e Obliqit. Unë edhe studiojsja edhe fillova të punoj. T'i ndihmoj edhe vetit edhe familjes, në Obliqi.

Kështu që n'atë kohë punojsha në Obliqi, '67-'68 dhe i vazhdojsja studimet. Atje krijova ni shoqëri prej 45 vetve sa ishim në teknik e inxhinier në termo elektranë. Filloj aktiviteti për msimin në gjuhën shqipe. Për arsye se tanë kohën aty e kemi pasë nifar' mësim për turbinat. Thojshin që 'Nuk ka mundësi të mbahen ligjerata në gjuhën shqipe po duhet vetëm në gjuhën serbo-kroate'. Atëherë në bashkëpunim me disa inxhinier të termo elektranës po edhe na së bashku me koleg tjerë, ngulëm kamë n'atë kohë se ka mundësi të mbahet në gjuhën shqipe.

Kështu që filloj nifar' greve në termo elektranë dhe arritëm sukses. I nxorëm msimin në gjuhën shqipe në termo elektranë. Krahës kësaj filloj edhe aktiviteti për organizimin e '68-tes. Arsya pse u fillu organizimi i '68 ishim proçeset e amandamenteve të cilat ishin ndryshimet kushtetare në Jugosllavi edhe në republika edhe në krahina. Gjithnji ne si student ishim aktiv në kto shkrime dhe në kto biseda me intelektualët edhe të Prishtinës po edhe të tjetër se çka po ngjan me rastin tonë.

Ne e kishim ni bindje se osht' momenti tash që Kosova të avansohet në republikë dhe të bashkohen edhe trojet tjera shqiptare në Republikën e Kosovës në ish Jugosllavi. Jo mundësia e ndarjes, nuk ka qenë atëherë në pyetje. Po kryesisht kjo. Në tona nejat, si në punë, si në fakultet, si në Ferizaj me shokë tjerë, kur u tubojshim faktikisht i diskutojshim kto, kto tema. Kjo temë kryesisht lindi nga studentët, nga grupi i studentëve të Prishtinës. Grupi i vazhdimësisë të bacit Adem Demaçit.

Atëherë u shpërndajshin disa fleta, do si fletushka po edhe niherit u shpërndajke edhe romani Tradhëtia e Kapllan Resulit. Edhe pse ishte e ndalune, atëherë na studentët, brenda natës e lexojshim këtë roman dhe t'nesrit ia dorëzojshim shokut tjetër që ta vazhdojnë. Ishte ni frymëzim i asaj kohe për gjeneratën e studentëve tanë...

Anita Susuri: E kto trakte që po thuni janë shpërnda, kto fletushka çka kanë, çfarë përmbajtje kanë pasë për shembull?

Hasan Abazi: Po edhe në demonstrata domethonë ka qenë kjo fletushka e Adil Pirevës ma vonë që e kemi marrë. Se pas shumë debateve që u bonën n'atë kohë edhe kërkesave që Kosova të avansohet në statutin e republikës. Atëherë thjeshtazi politika jugosllave me bashkë burokracinë e politikanëve shqiptarë në Kosovë e heshtën zërin e popullit për avansimin e Kosovës në republikë. Kështu që filloj diskutimet se si, se si të nihet zëri jonë. Ktë s'pari e kanë ba, thashë, grupi i Adem Demaçit, i t'rive të Adem Demaçit.

Dhe atëherë duke biseduar ndërmjet veti ishin të gjithë të bindur se osht' momenti për ni demonstrim që t'nihet zëri jonë në... pasiqë u bllokun, na shtypi kërkesat nga politikanët e tjerë. M'kujtohet me shokët në termo elektranë kur bisedum n'këtë drejtim. Atëherë ishte fjala vetëm për Prishtinë, jo edhe për qendra tjera. Ishim të gjithë t'gatshëm t'i bashkangjitemi ktyne ngjarjeve në Prishtinë. M'kujtohet Gani Graca, Enver Latifi, Bahtiri e tjerë të cilët, Ilaz Pireva... edhe pse me Ilaz Pirevën kemi punu s'bashku në termo elektranë po nuk e kemi ditur që ai osht' i lidhur drejt për së drejti me grupin e t'rive të Adem Demaçit.

Kështu që unë nuk e kisha ni obligim n'atë kohë. Vetëm të marrë pjesë edhe s'bashku me kolegët t'ju bashkangjesmi që t'bohët sa ma masovike. Me datën 25 nëntor duke u kthyer nga puna, në rrugën që çon kah fakultetet takoj Osman Dumoshin. Osmani po thotë, "O ku jeni ju ferizajlit? Kah qe dy ditë", thotë, "që ju kërkoj", "Hajde për hajër koft", thom, "çka?" Mbas përshëndetjes shkum në byfen e

Berishës. Atëherë në Shkollën e Lartë Pedagogjike ka qenë ni byfe e studentëve e qujshim byfeja e Berishës. Me pi nga ni kafe edhe me bisedue.

Në byfe aty bisedunum dhe Osmani e shpalosi atë që thotë, ‘Me datën 23 dhe 24 në shtëpinë time kemi vendosë që përveç Prishtinës të mbahen demonstrata edhe në qendra tjera të Kosovës, në mesin e tyre edhe për Ferizaj’. Atëherë unë u gjinda në ni pozitë shumë t’randë për arsye se ishin vetëm dy ditë për demonstrata. Po i thom Osmanit, “M’fal, krejt shoktë tjerë kanë shkue për Ferizaj me organizu që ata të vijnë dhe sa ma shumë demonstrues në Prishtinë. Tash nuk ka mundësi për m’u bo ni organizim i tillë për dy ditë”.

Gjatë bisedës disa herë me Osmanin ma shpjegoj edhe për parollat t’cilat planifikojmë që të dalin në Prishtinë. E parolla kryesore ishte parolla ‘Vetëvendosje! Kushtetutë!’ Nga Osmani nuk e përmendi republikën por Osmani thotë se, simbas tina, ‘Se republikën do ta thirrin vet demonstruesit’. Unë edhe nuk i premtova që do t’mundohna po nuk i premtova për arsye se isha i vetëm. Shokë tjerë të Ferizajit me t’cilët kisha mundësi për me bo ni organizim të tillë ishin në Ferizaj, s’ia disha mendimin e tyre.

Kështu që rashë në nifar’ depresioni t’ranë, e nijta ni barrë t’ranë të, me marrë për dy ditë me ba ni organizim. A me thanë jo, nuk ma thojke zemra as nuk ma thojke shpyrti që t’i thom Osmanit jo. Ai më njoftoj që ka ni organizim edhe në Gjilan edhe në Podujevë. Normalisht në ora 05:00, 15:55, do t’fillon, pesë minuta n’katër, do t’fillon demonstrata në Prishtinë.

Thashë, “Për Prishtinë jemi t’gatshëm të gjithë se kemi diskutu me shokët”, të tina dhe të mitë, “në termo elektranë”, se ishin të qasaj gjenerate, “mirëpo për Ferizaj”, thashë, “m’fal, nashta...” tha, “Pavarësisht a muni me organizu a jo”, tha, “mirë kishte me qenën që në mënyrën masovike të vini në Prishtinë. Se osht’ qendra administrative edhe këtu e ka peshën e vet demonstrata”. Edhe pse nuk e përjashtojmë mundësia e demonstrimit edhe në qendra tjera, po këtu osht’ qendra administrative edhe bon jehonë ma t’madhe”. Kto ishin fjaltë e fundit të Osmanit edhe na u përshëndetëm.

Ai vazhdoj rrugën e unë dola n’rrugë. N’vend se t’vazhdoj rrugën kah banesa ku banojsha, isha kthy në anën e kundërt të rrugës. Po ato kur t’çon zoti kshtu, me thanë, me kry punën atëherë të drejton edhe n’atë drejtim. Posa dola po m’thotë ni ish arsimtar i Shkollës Emin Duraku i Shtimës, Sherif Beqa, “O Hasan”, thotë, “po kah je nisë knena n’këtë anë?” “O Sherif”, thashë, “shumë mirë që t’pashë ty”. Ai në shkollën e Shtimës ka dhanën vizatimin, artin vizatimor. Thashë, “Shumë mirë”, thashë, “që të takova ty”, “Hë?” Thashë, “E kom”, thashë, “ni detyrë, ma kanë dërgu njëni”.

Edhe pse Sherifi e njofke familjen e Dumoshve. Se të gjithë studentët e asaj kohe që kanë studiu ma herët në ni formë kanë pasë përkrahjen e familjes Dumoshi. Kur ia përmenda emrin, se Osman Dumoshi m’ka obligue që t’mirrna me organizimin e demonstratës në Ferizaj nëse krijohen kushtet. Thashë, “Tash ti munësh m’i shkru parolla se dy ditë janë n’pytje”. E pashë që u skep pak në atë drejtim. Jo për shkak të frikës ose diçka po tha, “Kem problem për pare”, “Jo”, thashë, “mos ki dert”.

Atë ditë e kisha marrë unë rrogën në termo elektranë timen edhe t'ni far' shokut Rexhep Rexhepit që banojshim bashku. Kshtu kisha plot pare për m'i ble materialin. Thashë, "Për material nuk ka problem". Atëherë u drejtunum në Rilindje, shitorja e Rilindjes u kanë dhe ni shitore Prosfeta me ble hamer. Atëherë hameri u kanë ni letër e trashë kur bojshim na vizatim teknik. Se letra tjera s'kishim.

Shkunum me Sherifin. Po t'u shku te anena po m'thotë Sherifi thotë, "Në qoftëse dikush na pytë, i thu që janë në shkollën e lartë pedagogjike t'u përgatitë provimet e po m'vyn me bo vizatimet. Kjo le t'jetë parolla jonë në qoftëse dikush". Se ajo ishte ni shumë e madhe e parollave me ble. Letra për parolla me ble. Kështu që e morëm në dy librari të asaj kohe në Prishtinë edhe u drejtum në banesën, u kanë në rrugën e Prizrenit numër 36. Në atë far' banese jo fort e madhe ka qenë tri me katra. Aty kemi filluen me i shkru parollat.

Unë e kom pasë edhe ni cimer, ni Mehdi Salihu edhe i thashë, "A je i gatshëm që t'na ndihmojsh?" Tha, "Çka kom une?" Thashë, "Ti veç duhet të terësh ngjyrën e parollave". Për arsye se vendi ishte i ngushtë e parollat për mos m'u prishën atëherë u dufke m'i terën...

Anita Susuri: Çfarë parolla keni shkru?

Hasan Abazi: Parollat krye kput parolla që u ka pri u kanë, 'Vetëvendosje! Kushtetutë!', shumicën e saj. 'Dum universitet! Gjuha shqipe t'jetë e barabartë! Poshtë byrokracia!' të gjitha kto. Veç krye kput parolla kryesore ka qenën, 'Vetëvendosje! Kushtetutë!'. 'Lirimi i t'burgosurve politik!' E tjera, e tjera. Kto kanë qenën parollat kryesore. Deri në ora 05:00 në mëngjes të datës 26 i përfundum 150 parolla në atë kohë me Sherif Beqën. Sherif Beqën e vendosëm në banesën e atij shokut, Rexhep Rexhepi me flejt e unë rash në parolla qashtu. Parollat përmi e deshta ta boj ni gjum sado kudo t'pushoj pak. Se ishte pak muzgu.

Kah ora 08:00 troket në derë njëri i dytë tash i cili faktikisht ma mundësoj vazhdimin e aktivitetit. Ishte Muhamet Sylejmani Mani, i cili kishte ardhë prej Ferizajit në Prishtinë me pytën se çka ka t're edhe n'fakultet po edhe me pytë... zakonisht të gjithë që ardhshin prej Ferizajit, ma së pari ardhshin në banesën tonë aty. U takojshim, bisedojshim edhe vazhdojshim me aktivitete tjera. Edhe erdh. Ia çelëm derën, u fut mrena dhe pa parollat, "Çka janë", tha, "kto? A për Prishtinë janë kto parolla?" Se s'kishte idenë që do t'pregatitën për Ferizaj.

Mas ni kohe duke pi kah ni çaj që na maroj Mehdi Salii i tregoj thashë, "M'fal", thashë, "du të tregoj", thashë, "unë dje e kom marrë për obligim që të organizojmë edhe për Ferizaj demonstrata edhe po pres nga ti a je i gatshëm që me m'përkrah se pram kto i kom shkru". Nuk ia përmenda emrin e Sherifit, gjithnji duke rujtën konfidencialitetin e personit. Pa një pa dy pa asnjë hezitim tha, "Unë jom i gatshëm me të ndihmu edhe me u bo bashkë organizator", "E", thashë, "shumë mirë". Domethonën unë tash mora edhe fuqinë e dytë pas ksaj që u krytën parollat.

U terën pjesët edhe menojsim tash se si të shkojmë për Ferizaj. Atëherë ishte para festët 28-29 nëntorit ishte edhe aktiviteti i policisë shumë i ngjeshur. Në çdo cep ishin policia, kontrolle, agjeturat e ish Jugosllavisë dhe ishte pak rrezik m'i bartë parollat prej Prishtinës në Ferizaj. Atëherë mendum se ardhke ni autobus, zakonisht në ora 04:00 pasdite prej Novi Pazarit, pazarit të ri. Dhe me atë shpesh herë na kemi udhëtu prej Ferizaj. Ai shkojke prej Novi Pazarit për Shkup dhe shumica e pasagjerëve ishin musliman të Novi Pazarit. Ashtu ata e thojshin, boshnjakët e Novi Pazarit. Po na e dijmë që prejardhja e tyre ka qenë gjithnji shqiptare po çka t'i bajmë.

Atëherë vendosëm që t'dalim afër spitalit ku nalet zakonisht autobusi. I mbledhëm parollat, i rregullum me anë të gazetës Rilindja dhe ashtu i morëm me Muhametin dhe shkunum në Ferizaj. Gjatë rrugës, ai kondukteri ishte i moshës tonë, e kishte pasë emrin Enver. Mani e pyti tha, "Si e ki emrin?" Tha, "E kom Enver", tha, "E gëzofsh e paske ni emër t'mirë". T'u aludu në emrin e Enver Hoxhës. Tani për fatin tonë nuk kishte pasë vende t'lira tjera edhe autobusi nuk u nal. Se na tash ishim në ni antkh mos po hyn naj kontrollë, na i zen parollat. Nuk osht' problemi që a i zen parollat po ish problemi që nuk kemi mundësi të organizojmë demonstratat.

Kah ora 05:00 pasdite mbrinëm në Ferizaj. Në dyqanin e Muhamet Sylejmanit i vendosëm parollat me nifar' tunelli. Baba i Muhametit punojke rrobe, posaçërisht xhamada punojshin për qytetarët e moshuar. Po nuk kishin qenë ata prezent aty kshtuqë Muhameti i vendosi parollat derisa të takohemi me shoktë tjerë në Ferizaj. Pasi i vendosëm parollat, u lirum nga ajo barrë. Atëherë fillunum me dalë në qytet. Duke shkuar, ende pa u diskutu kto me shokë tjerë takojshim nxanës, qytetarë posaçërisht Mani i njofke qytetarët e Ferizajit se si vendas edhe si njëri i cili u marrë me zejen e rrobaqepësisë atëherë i njëfshin ma shumë qytetarët.

Bisedum, 'Çka ua merr menja? A jeni për ni demonstratë nesër? A na përkrahni?' Shumica e tyne na përkrahshin po kishte edhe prej tyne që nuk e dishin çka osht' demonstrata. Kështu që ishte ni çashtje për arsye se deri n'atë kohë nuk ka pasë demonstrata. Atëherë m'u ka dashtë një grupi prej dy-tre vetve t'ju shpjegoj se cila osht' demonstrata. 'Kur kemi bo protestë për Vietnam'. Atëherë lufta ishte në Vietnam. Qashtu edhe parolla edhe qashtu kalojmë. 'E tash p'e dijmë se çka koka demonstrata'. Kështu që kah ora 06:00-06:30 në kthinën e Hotel Lubetenit i takonum edhe shoktë tjerë. Do ardhshin ma vonë veç kryesore u tubum na shoktë e celula e organizimit të demonstratës në Ferizaj.

Aty ishte Ismet Ramadani, Avdullah Zymberi, Ibrahim Sylejmani, Mustafë Sejdiu, Hajredin Salihu, Beqir Beqiri. Këta ishin faktikisht të vendosun në atë tryezë ku mrrinëm edhe unë edhe Muhamet Sylejmani. Ma vonë kah ora 11:30, nga, Rijeka erdh Hysen Muhaxheri. Student edhe koleg i joni i shkollës teknike. Ai na u bashkangjit në atë mramje. Kështu që aty u vendos definitivisht, pasi i njoftova unë dhe Muhameti që 'Përveç Prishtinës osht' bo vendimi që t'bohet organizimi edhe n'qendra tjera'. "Kam marrë si obligim moral, jo obligim obligativ, po obligim moral që të bojmë organizimin edhe në

Ferizaj”. I njoftova që osht’ përgatitën parollat, janë pru, janë t’gatshme vetëm duhet t’vendosen në korniza të druve.

Atëherë i pari që e mur’ fjalën ishte Ismet Ramadani i cili tha, “Unë jom”, tha, “për me organizu”, edhe pse ishte vetëm në ditë. Faktikisht ishte, tashti, me 26 ishte mramja derisa na bisedojshim na faktikisht ajo koha shkojke. Faktikisht ishte vetëm 27 paradite se si m’u bo organizimi. Mas Ismet Ramadani e mur’ fjalën edhe Avdullah Zymberi po edhe të tjerët edhe në bashkëbisedim të gjithë unanimisht përkrahën organizimin e demonstratës me 27. Këtu i dajtëm detyrat se kush çka do t’kryj, obligimet. Si koordinim të punëve mbeta unë, ndërsa referatin për shkruje e mur’ Ismet Ramadani dhe Avdullah Zymberi. Ata e morën që ta shkrujnë referatin i cili do t’lexohet para demonstruesve në qendër të qytetit.

Aty Ismet Ramadani tha se ‘Unë edhe e marrë e shkruj referatin edhe e lexoj para qytetarëve, para demonstruesve’. Kështu që në barrë t’madhe e murr’ Ismet Ramadani, i ndjerë. Këtë shok e kanë vra forcat serbe me datën 25 mars 1999. Faktikisht nga aktivitetet që janë ba t’ma hershme ka qenë n’sy të pushtetit. Për shkollën normale e dajtëm Muhametin, Muhamet Sylejmani e murr’ obligimin edhe Mustafë Sejdiu për shkollën normale. Për shkollën teknike e mora unë dhe Avdullah Zymberi obligim që me mobilizu. Për shkollën ekonomike e morën kolegët e tjerë aty Beqir Beqiri e tjerë. U mur’ përsipër që Beqiri të sjellë letrat për përgatitjen e kornizave në vendin ku do ta caktoj unë.

Unë e mora obligim që ne me gjetë në banesë, në vend të cilin e kisha veç synim qysh ma herët. Ka qenë banesa e nifar’ Hasan Salihut në rrugën Zenel Hajdini. Aty e disha që nuk ka t’përzin me qytetarë. Janë kushtet për me grumbullu materialin. Kështu që në ora 12:00 e përfundum mbledhjen dhe të gjithë u vendosëm që ditën e nesërme të shkruhet në parollë. ‘Vetëvendosje! Kushtetutë! Republikë!’ Ktë e propozoj Hysen Muhaxheri, i cili erdh nga Rijeka dhe tha se ‘Nga Kroacia ka lajme që Kosova duhet ta fitoj republikën’. Prandaj e thotë, “Na duhet të shkrujmë”, unë i thashë se, ‘Këtë sugjerim nuk e kom po do ta thrasin qytetarët vet’, “Jo”, tha, “ne”, tha, “do ta shkrujmë”.

Atëherë ram dakord që ta përgatitim edhe qat’ parollë e shkruje me në drasë, panel që i kanë thanë, iveric n’atë kohë. E shkrujtëm, ‘Vetëvendosje!’ me ngjyrë të kuqe, ‘Kushtetutë! Republikë!’. Ajo parollë iu ka pri demonstratave tani me datën e 27 nëntorit. Me 27-tin të gjithë ishin aktiv edhe bashkëorganizatorët, se s’muj t’i la anash bashkëorganizatorët, Enver Ramadanin e shumë koleg tjerë. Të cilët shkollave t’mesme pa hezitim kanë ndihmue në këtë drejtim.

Faktikisht deri në ora 12:00 të ditës janë siguru edhe kornizat e parollave, janë siguru flamujt, flamuri jugosllav, flamuri i partisë dhe nga kafeneja Skenderbeut, në djalë i shkollës normale me sygjërimin tim ka shku e ka nxjerrë flamurin... se disa kohë ma herët në këtë kafën skënderbeu osht’ qit’ flamuri i vizatum shqiptar dhe nga ajo kohë shkojshim edhe ne si t’ri me kqyrë me vëzhgu përreth asaj kafehane flamurin. Atëherë ishte diçka ende e ndalune, ende nuk ishte pru vendimi që flamuri kombëtarë të

valvitet. Kështu që i kemi grumbullu dhe kah ora 02:00 unë si i ri, isha bo pa rru. Thashë, ‘Si muj me dalë para demonstruesve, para nxanësve’, se shumica e tyre ishin nxanës, student ‘n’këtë formë’.

Hina te ni berberhane aty edhe po i thom, “A ka mundësi me m’shejtu për me m’rru se kom nifar’ pune”, për mos m’i tregu për çka ish fjala. Tamon filloj berberi që të asi erdh Ismet Ramadani dhe Avdullah Zymberi edhe n’vesh po m’thojnë se, ‘U alarmu policia edhe komuna. Shpejt duhet të organizohemi se përndryshe dështon organizimi’. Atëherë e kom fshi sapunin dhe jom dalë, e kom gjetë ni kerr. Se çerrja të cilën ne pritshim që t’i bartë parollat duhke me ardhën në ora 14:20, dhjetë minuta para nisjes së demonstrimit. Demonstrimin e vendosëm ni natë ma herët. Fillon në ora 14:30 dhe përfundon në 15:30. Domethonë për ni orë të t’kem kohë që t’shkojmë për Prishtinë.

Atëherë e kom marrë ni çerre t’parkune, atëherë i kemi thanë ne para modës, dhe ai tha, “Jo se kalin e kom”, çerrja ka qenë e ni fshatit të Reqakut të Shtimës. Thashë, “O’ bre materiali osht’ i lehtë a din edhe unë paguj mirë”, “Sa pagun?” Thashë, “Po 500 dinar”. 500 dinar ishin si me thanë 500 euro. Atij iu dok shuma e madhe edhe e kthej kalin për me shku m’i marrë materialet. Mirëpo ai nuk i grahke kalit se iu dhimke, kali i vet a p’e din. Atëherë u detyrova unë me ia marrë kalin për arsye se kisha përvojë na fëmijëria dhe e shpejtova. E shpejtova çashtjen.

Mbriva te internati, vendi ku ishin tubu studentët, qytetarë, nxanësit e shkollës t’mesme ekonomike, tregtisë, teknikës, normales. Kto ishin edhe të gjimnazit. Qat’ kohë ni numër sa ka qenë i mundshëm të grumbullohet. Aty m’kujtohet momenti kur i kemi pru si njifar’ hezitimi i qytetarëve. Atëherë kom thirrë shoktë edhe studentë a din që t’i marrin parollat edhe t’fillon marshimi. E kisha qëllimin jo veç unë po edhe shoktë tjerë, organizator që ishim, që sa më parë t’fillon marshimi. T’u e ditë që mujnë me ardhë në çdo moment me na rretheku aty policia edhe tash si fëmijë ka mundësi edhe me u frikësu edhe me dështu ajo.

Kështu që filloj marshimi. E patëm edhe fotografinë e Titës e kemi marrë me qëllim. Që kur e kem fotografinë e Titës nuk na ngucin policia. Kjo ka qenë moda. Ata na thanë ma vonë se, ‘E keni kamoflu ju që keni marrë fotografinë e Titës se ju jeni konë kundra Titës’. Mbas 100 metrave erdh kryetari i komunës, sekretari i partisë e funksionar në polici civile, jo të uniformës dhe na doli n’rrugë. Atëherë Sinan Sahiti ka qenë kryetar i komunës edhe po thotë, “Kjo duhet m’u nalë se kjo osht’ vepër e Rankoviqit”. Atëherë filloj t’u nxen gjakrat, ajo na ndihmoj që edhe ma shumë tash të marrim ni vrull që t’mbrrijmë në qendër të qytetit.

Konfrontimin e patëm aty me udhëheqësin po ata kur e panë alarmimin e demonstruesve u largun nga vendi. Po na kishin qitën përpreken te moda, rruga trekandëshi i rrugës Neredime, Shtime edhe qendër e qytetit. Aty e kishin bo ni kolonë të policisë dhe deri t’mrijmë te kolona atëherë kom ftu të gjithë shoktë student edhe do ma t’gjatë, kanë qenë do taraba. U thynën tarabat e banesave edhe atëherë filloj konfrontimi nërmjet policisë edhe demonstruesve. M’kujtohet që unë me ni koleg dojshim me ia nxjerrë pedrekin ni policit n’dorë po ata p’e lidhshin për dore që s’kishte mundësi. Kolona t’u

piskat, 'Vetëvendosje! Kushtetutë! Republikë!' mrrijnë në qendër të qytetit, e thyn kordonin e policisë edhe mrrinëm në qendër të qytetit.

Qendra e qytetit faktikisht na e patëm planifiku që Ismet Ramadanit me ia qitën me ni karrocë t'hamamit që t'jetë mbi qytetarë mirëpo ato kishin qenë të lidhura me dry edhe ne nuk patëm mundësi ta nxjerrim atë. E hypëm në ni bankinë të luleve edhe ai filloj ta lexoj referatin aty. Me fillimin e leximit të referatit shkoj deri në gjystë të referatit. Atëherë intervenun policia me gjithë zjarrfikës edhe filloj konfrontimi nërmjet policisë edhe demonstruesve. Por na patëm sugjeru demonstruesit që njerzit civil që janë mos m'i ngucën, pavarësisht që vijnë. Këta policët civil e shfrytëzojnë rastin edhe mrapa neve vijnë m'gjujnë s'pari mu para policisë edhe zjarrfikësve edhe ma vonë edhe Ismet Ramadanin. Na rrafën policia edhe na lagën kshtu. Po megjithatë demonstrimi vazhdoj.

Demonstrimi ka vazhdu deri në ora 15:30. Koha... e kishim qëllimin që në ora 15:00 të dalin edhe punëtortë nga uzinat dhe ta shofin, t'i shofin fmitë e vet se çka janë t'u kërk. Nuk kemi dashtë t'i përzijmë punëtortë në demonstrata. Me qëllim të ruajtjes së tyne se i largojshin nga puna e me largimin e ni punëtori nga puna ishte problem edhe familja. Kështu që tanë kohën me shokë kemi bisedu që mos me pasë t'inkuadrun punëtorë por t'jenë bartës kryesor studentët e Ferizajit, normalisht edhe me nxanësit që janë në Ferizaj.

Kështu që ne në 15:30 në Ferizaj u grumbullu diku ni numër deri pesë mijë demonstruesve. Ktë e kanë përcjellën edhe nëpërmjet Radio Ferizajit po edhe njëherit gjatë hetuesisë këtë pyetje ma kanë shkru disa herë, "Si mujt ju t'i grumbulloni mrena dy dite pesë mijë vet? Kur ne tre muj ditë për ni miting duhet me bo propagandë e me menzi që i bijmë pesë mijë vet në ni miting?"...

Anita Susuri: E n'demonstrata a ka pasë t'plagosun?

Hasan Abazi: Ni... unë sipas meje vajza e cila e ka bajtën fotografinë e Titës i ka mshu ni polic dhe e ka lëndu e tani kolegët e vet kanë çu deri në ambullantë. Ma vonë kom ndëgju që ka pasën kshtu të lëndun prej demonstruesve po për shkak të situatës burgosjes nuk janë lajmëru. Ndërsa polic ka pasë edhe zjarrfikës të lëndun. Ka pasë edhe dame materiale.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Kur kanë fillu arrestimet?

Hasan Abazi: Po arrestimet kanë fillu qysh atë ditë. Posaçërisht i kanë marrën nxanësit e shkollave, shkollave ekonomike, teknike e tjerë. Për me dëshifru kush janë organizatorët, a po kupton? Në bazë të bisedimeve që e kanë ba edhe hetuesisë atëherë kanë fillu edhe arrestimet edhe të grupit tonë organizator. Harrova ta përmendi pak para se me ardhë. Referatin e ka marrë Ismet Ramadani,

Avdullah Zymberi për me shkru. Po këtu ju ka ndihmu edhe e ka shkru Ali Mehmeti. Arsimitar i shkollës të mesme ekonomike po njihërit edhe shok i Skender Kastratit këtu në Prishtinë. Organizatorët e demonstratave për Prishtinë.

Kështu që referatin e shkrum me makinë të shkrimit për arsye se ka qenë profesor i daktilografijes. E ka marrën kah ora 02:15 Ismeti me gjithë Dullën nga Ali Mehmeti. Ali Mehmeti e ka edhe ni rol tjetër se s'muj... për arsye se nuk i ka nalën ose nxansat e shkollës ekonomike të tregtisë që të dalin në demonstrata. Në ni formë ka vëzhgu dhe ka përkrahë demostrimin nga pjesa tjetër. Domethonë si bashkëorganizator edhe ky me gjithë Jakup Mehmetin.

Po drejtpërsëdrejti nuk kanë qenë organizator po bashkëorganizator të cilët edhe ma vonë i kemi marrë vesh nga nxanësit e shkollës ekonomike dhe të tregtisë. Kështu që filloj burgosja. Mue edhe Ismet Ramadanin na kanë burgosë me 03 dhjetor. Disa koleg tjerë ma herët veç mu Ismeti edhe Alijen faktikisht me 03 dhjetor jemi, jemi burgosën...

Anita Susuri: Në vend të punës iu kanë marrë apo si?

Hasan Abazi: Jo, unë, kanë ardhën, m'kanë marrën në banesë në Prishtinë. Në banesën në Prishtinë m'kanë marrë. Kishin qenë dy-tri herë po nuk e kanë ditë banesën ku kom banu une. Atëherë me ndihmën e ni shokut... se na nuk e kemi pasë fjalën me ikën. Na e kemi pritën burgosjen, na e kemi pritë edhe vrasjet a po kupton? Kemi qenë të vetëdijshtëm se koha e Rankoviqit ka tregu që s'kanë lanë gja këta pa përdorën. Fati ka qenë që këtu u kanë ajo perioda e Rankoviqit ndoshta edhe vrasjet kishin qenë në edhe në demonstrata edhe në Ferizaj edhe në vende tjera. Siç e kem rastin e vrasjes në Prishtinë të Murat Mehmetit.

Kështu që pas demonstratave në Ferizaj, une me Ismet Ramadanin kemi hypë në trenin e mallrave deri në Lipjan. Në Lipjan aty me ni autobus n'atë kohë e qujshin llokall, llokall i kuq dhe kemi shku për Prishtinë. Në momentin kur ka fillu demostrimi në Prishtinë kemi qenë pjesëmarrës edhe na por anësor. E kemi njoftu Osmanin, Afrimin edhe shoktë tjerë se, 'Në Ferizaj me sukses ka kalu demostrimi'. Kështu që kemi vazhdu demostrimin në Prishtinë por pasi që ishim të lagun edhe të rrafun atëherë u detyrum që na t'shkojmë n'banesë t'i ndrojmë rrobet. Për arsye se filloj edhe plagët tash fillun të ftofen, u nijshin ma shumë.

Kështu që nuk kemi marrë pjesë deri në fund të demonstratave në Prishtinë por diku rreth nja dy orë kemi qenë së bashku me kolegët e tjerë të Prishtinës. I kemi pa edhe i kemi vëzhgu edhe ne thirrjet, 'Vetëvendosje! Republikë!' Këtu në universitet të cilat janë shkoqit edhe në... bile këtu në Prishtinë ka qenë numri i madh. Për çdo herë ardhke u rritke numri i madh i demostruesve. Na e vrejtem që këtu u bo ni organizim pak ma i madh në krahasim me Ferizajin. Edhe pse në qendra tjera nuk e dishim se si kanë kalue. Pas burgosjes 36 ditë t'plota jam mbajtë me ni zyre...

Anita Susuri: Në Prishtinë këtu?

Hasan Abazi: Jo, në Ferizaj. Katin e katërt në Sekretariatën e Punëve të Brendshme. Aty 36 ditë nuk m'kanë leju me shku as n'dhomë me fjet, m'kanë lanë pa fjetë. Natën kanë ardhë inspektorët federativ Adem Gashi dhe Drago Bojiçi na kanë marrë në pyetje. Ditën na kanë marrë n'pyetje këta inspektorët ma t'vegjël të Ferizajit. Kështu që mas pesë mujve e diçka, mas krejt sherrimit e bisedave informative u organizu edhe gjykimi. Kështu që ne në gjykim... gjykimi u mbajt në Ferizaj. Gjyqtar ka qenë Tade Erodiçi ndërsa prokuror Mentor Jakupi.

Unë publikisht mund të thom dhe i falënderoj të dytë edhe pse të dytë nuk janë tash n'jetë po unë i falënderoj për shkak t'familjes tyre. Ata kanë mund neve t'na dënojnë shumë ma shumë se n'bazë numrit të demonstruesve Ferizaji mas Prishtinës ka qenë me numër ma t'madh. Tade Erodiçi me ndihmën e profesorit tonë Pasë Stakës, profesor i gjuhës shqipe që na ka dhanë kanë qenë kojshi këtu në Prishtinë. E ka lutën që ai t'vjen t'na gjykon në Ferizaj. Për arsye se kryetari i gjykatës në Ferizaj Halil Ilazi ka qenë dhandërr i Ismetit. Për shkak t'lidhjeve familjare atëherë nuk ka pasë t'drejtë t'na gjykoj neve. Kështu që osht' caktu Tade Erodiçi prej Prishtinës.

Dënimin prej ni viti e ka marrë Ali Mehmti, që ka shkru referatin edhe si arsimtar. Dënimin nga dhjetë muj kemi marrë unë dhe Ismet Ramadani si organizatorë të demonstratave të '68-tes. Kështu tjetër Muhamet Sylejmani këta tjetër i kanë majtë kah ni muj burg. Muhamet Sylejmani, Avdullah Zymberi, Beqir Beqiri e tjerë të cilët tash për momentin nuk po muj m'i... Hasan Muhaxheri, Sylejman Bytyçi e tjerë. Këta janë dënu me kah ni muj burg.

Anita Susuri: E ju dhjetë muj ku i majtët?

Hasan Abazi: Tanë kohën i kemi majtë në Burgun e Ferizajit. Pjesën e parë nën hetuesi thashë pesë muj e diçka dhe pjesën tjetër në hetuesi, mbas hetuesisë na i kemi majtë prap në Ferizaj. Vetëm Ali Mehmeti e ka majtë pjesën e dytë në Burgun e Goliotokut në Kroaci.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Burgu i Ferizajit?

Hasan Abazi: Po burg hetues ka qenë, burg hetues. Thashë pjesën e parë kom qenë në dhomën numër dy unë. Faktikisht i vetmum se nuk kanë leju askënd me ardhë aty se gjoja po i motivojmë edhe na për me kallximet tona po i motivojmë njerëzit që edhe ata t'bahen organizatorë ose vendimi i hetuesisë nuk e di se si asi... ndërsa në pjesën e dytë ka qenë pak ma rand. Për arsye se shumë qytetarë janë dënu për kundërvajtje, për dru e për vjedhjen e pulave e tjerë e tjerë. Kështu që tanë kohën kemi nejt me ta. Edhe pse unë i falënderoj se kanë pasë ni respekt ndaj neve.

Të gjithë qytetarët të cilët kanë ardhën në atë burg po edhe tjerë që janë kanë jashtë, kanë pasë ni respekt ndaj neve. Respektin e kanë shprehë edhe me dërgimin e jo cigareve, jo napolitankave e diçka

ksi soji. Shumica e tyre nuk janë identifikuar se kush janë veç kanë thanë, 'Çojani atyne demonstruesve të '68-tes'. M'kujtohet vetëm mos me lanë anash në qytet në Balique e kishte mushë në breme në i kena dhanë, në thes me dardha, molla edhe ia bëjnë gardianëve. I thotë, "Merri qito", thotë, "edhe çoja atyne trimave të '68-tes", a po kupton? Edhe ai gardiani jet' thotë, "Qysh ti gjithë kto ku m'i çu unë?" Thotë, "Merrija çoja atje, i shkepin ata i dijnë". Osht' baba i Ismet Sadikut nga Balajt e Ferizajit.

Anita Susuri: E deri në atë kohë nuk keni qenë në martun?

Hasan Abazi: Jo.

Anita Susuri: A keni pasë kështu kontakt me familjen a kanë ditë familja?

Hasan Abazi: Nihërë në fillim familja nuk e ka ditë që unë jom burgosën. Pas një dhetë dite atëherë thotë ai Adem Gashi inspektori thotë, "A e din familja?" Thom, "Ku e din familja. E din familja që jom në studime, nuk e dijnë që jom i burgosur", thotë, "A ki mundësi", thotë, "dikond", thom, "Po, qitu përballë e kom në shok, në Ibrahim Sylejmanin", thashë, "osht' ai që ka mundësi me shku deri te familja". Atëherë e kanë sigurë që ka ardhë edhe familja tani me m'vizitu. Faktikisht baba ma së shumti ka pasë brengë po çka me bo. Unë si i ri nuk... unë kom thanën babës në takimin e parë, "Hajt babë, i ki edhe dy djem tjerë. Mos ki dert për mue".

Anita Susuri: E qysh ka qenë për shembull rregullat e burgut? A ka pasë dhunë fizike?

Hasan Abazi: Dhunë fizike nuk ka pasën, a po kupton? Dhunë fizike nuk ka pasë po dhuna psikike edhe dhuna tash që 36 ditë mos me mujtë me flejt edhe ajo... gjatë 36 ditëve pesë polic na kanë rujtën. Tre polic kanë qenë përballë tavolinës ku kom qenë unë, një polic ka qenë te dera edhe në polic ka qenë në korridor. Unë po e flas për veti. Gjatë bisedës me inspektorët federativ, kryekput, Adem Gashi ka qenë inspektori jem, me preferencën e Ismet Ramadanit. Për arsye se unë ma pak e kom njoftë gjuhën serbo-kroate kurse ai e ka njoftë pak ma mirë se nga qyteti i Ferizajit.

Thotë, kur janë marrë vesh asi, thotë, "Kush flet serbo-kroatishtën ma mirë?" Thotë, "Unë e flas e Hasani", thotë, "ma pak". Edhe aty ka qenë në ndihmesë e shokut ndaj shokut, solidariteti i shokut ndaj shokut. Kështu që Adem Gashi kur ardhke me inspektorët e tjerë shoqëruar shqiptarë thojke, "Po frikësoj se mos po del në kështu prej Rankoviqit". Ajo ishte brengë, ajo ishte thikë për mu, a po kupton? S'ishim na, çfarë fjale e Rankoviqit. Kur ardhke me shoqëruar serb thojke, "Po frikësoj diçka", thojke, "se mos ka diçka përtej ktyne maleve të Jezercit", domethonë për Shqipërinë.

Kështu që edhe njana edhe tjetra nuk qëndrojnë. Për arsye se faktikisht ishte momenti i popullit tonë në atë kohë që me avancu çashtjen e Kosovës në republikë. Kjo ka qenë ai momenti i asaj gjenerate. Po falë studentëve, intelektualëve e posaçërisht vllavi i Osman Dumoshit, Ismajl Dumoshi i lidhun në mes legales dhe ilegales a po kupton? Ai ka bo me intelektualët, edhe pse ka qenë mrapa, ai e ka bo këtë

organizim me ni formë sipas të gjitha njohurive që unë kom t'ma vonshme që ai profesor i gjuhës shqipe, t'cilin e kom njoftë në Obiliq e ka qenë ni intelektual i cili ju ka pri gjanave për interesin kombëtar tonin.

Kështu që kjo thanje e inspektorit ishte ma shumë se goditje. Se ta jep naj shuplakë edhe kalon po kjo ishte e randë. Mirëpo edhe ajo, edhe ajo kaloj. Tanë kohën thojshin, “Ju s'po doni me tregu”, thojke, “se ju e dini cili profesor”, aludojshin te profesorët ose njerëzit e pushtetit, “kush ju ka tregu juve që osht' nalë rruga për republikë? S'u nalë, me bisedime, me dialog”. Kom thanën që, ‘Dialogu ka përfundu dhe me dialog e keni shu mundësisjen e bisedimit’. Se mbledhja e fundit osht' majtë në Prishtinë e përcjellshim Rilindjen n'atë kohë. Aty osht' marrë vendimi që heshtazi të ndërpritet aktiviteti për republikë, nën shtypjen e serbëve, malazezëve dhe maqedonëve domethonë.

Anita Susuri: A ke viti '70 kur keni dalë prej burgut apo?

Hasan Abazi: Po, viti në '69 pjesa e parë tani në tetor të vitit '69 kom shku për pjesën e dytë, domethonë në 1970 kemi dalë prej burgut.

Anita Susuri: A keni mujtë me vazhdu normal punën? Fakultetin? Apo...

Hasan Abazi: Për fakultet e humba mundësinë me shku për arsye se indeksin ia pata lanë ni kolegut mirëpo ai nga frika e profesorëve të Beogradit edhe të pushtetit ai nuk e ka qit' indeksin tim për me marrë nënshkrimet. Kështu që unë e humba mundësinë dy vjeçare të... atëherë provimet që i kisha dhanë edhe kisha regjistru vitin e parë, kisha dalë në vitin e dytë të fakultetit, u detyrova m'i marrë provimet edhe me shku në shkollën e lartë teknike në Mitrovicë. Atje në shkollën e lartë teknike në Mitrovicë e kom përfundu shkollën e lartë dhe jom inkuadru në fabrikën e veglave në Ferizaj.

Kështu që mas daljes nga burgu kom vazhdu me korrespondencë në shkollën e lartë teknike dhe kom fillu me punu për arsye se vllau ishte në studime në Shkup në Fakultetin e Pylltarisë dhe Industrisë së Duhanit. Kështu që ishte barrë për familje për me na mbajtë te dyve në studime. Humba vendin e punës në termo elektranë, më përshtun nga puna. Ajo mundësi m'u shu por lindi ni konkurs në fabrikën e veglave në Ferizaj. Atëherë konkurum dy koleg aty edhe pasi që ishte mungesa e kuadrit teknik, atëherë na pranunën. Mirëpo nga burgu i vogël që isha, dola në burgun e madh. Burgu i madh ishte jashtë, burgu i madh me peripetitë e popullit tonë ishte jashtë, a po kupton?

Anita Susuri: A keni vazhdu pastaj me aktivitetet politike apo keni punu?

Hasan Abazi: Deri në vitet e '90-ta kom punu, jom martu, kom pasë kriju familje, isha në shërbimin ushtarak. Dhe gjatë kohës '70 masi u inkuadrova dhe masi isha edhe mësimdhënës në shkollën teknike. Mirëpo n'atë kohë lindi letra e Titës që të gjithë ata të cilët janë të dënuar për çashtje politike të largohen nga arsimi. Kështu që drejtori...

Anita Susuri: Cilin vit m'falni?

Hasan Abazi: Po vitet e '72-'73, qatëherë ishte ajo letra e Titës që u përhap nëpër tanë Kosovën, 'Që të gjithë të dënuarit politik duhet të largohen nga arsimi'. Unë n'atë kohë dhasha edhe punojsha në fabrikën e veglave edhe dhasha konstruksione të veglave i dhasha në shkollën teknike dhe teknologjike. Kështu që më thirri ish msusi im, Xhemajl Kosumi, ose tash drejtor i shkollës tha, "Hasan", tha, "kemi", tha, "ni urdhnesë nga komiteti. Letra e Titos qishtu", tha, "kisha propozu që t'mos bëhet shumë e madhe që t'diskutohet", tha, "jep ti dorëheqje edhe ma propozon ni koleg që t'zëvendëson ty".

Atëherë në mirëbesim në mes veti unë u largova dhe propozova Hysen Muhaxheri nga Rijeka që t'i vazhdon msimin në shkollën teknike. Kshtu edhe letra e Titës mas burgut '68-tes si peripeti erdh letra e Titës ndaj të gjithë burgosurve politik. Jo vetëm gjeneratës tem po edhe atyne t'ma hershme domethonë...

Anita Susuri: E kjo letra e Titës, a është ni letër e hapur a çka?

Hasan Abazi: Letër e hapun u kanë kshtu që ka përmbajtë çashtjen politike, me dekret politik që, 'Të gjithë të burgosurit politik që janë të dënun nuk mund të janë në institucionet arsimore me qëllim që t'mos'...

Anita Susuri: Mos me ndiku te gjeneratat e reja. Deshta me ju pytë, e përmendet edhe shërbimin ushtarak, ku keni qenë? A keni pasë pastaj problem?

Hasan Abazi: (Qeshë) Unë thashë, nga burgu i vogël ke dalë në burgun e madh dhe peripetitë e dënimit nuk janë kanë, nuk osht' burgu që e ke majtë dhjetë muj. Po të gjitha ato përcjellset që i kanë mbetë në autobiografinë tane, posaçërisht pushteti i asaj kohe i ka përcjellë. Unë pas letrës të Titës me qëllim të ruajtjes të vendit të punës në fabrikë, se edhe aty u diskutojke që këtu janë mbledhën irredentistët. Aty punojsha unë, punojke Ali Mehmeti, Jakup Mehmeti, Ismet Sadiku, ishte si referent për kuadra. Tash na akuzojshin krejt se janë mbledhë këtu irredentistat në këtë fabrikë, në këtë uzinë këtu.

Atëherë me qëllim të pak të shtensionohet situata kërkova prej Ismet Sadikut vendimin me shku n'pushim edhe prej Enver Sojevës kërkova, referent i mbrojtjes popullore, që t'shkoj ta kryj shërbimin ushtarak. Unë e luta atë që diku mundësisht në Maqedoni pasi që isha i martuar, e kisha ni djalë n'atë kohë. Ai tha, "Nuk ka mundësi këtu", tha, "ti je i parapan me shku në Kiselan te Sarajeva". Ni vend atje. Tamon kur shkova atje, fillun ato peripetitë edhe atje. Mbikqyrja, i kom pasë dy persona. Ni kroat edhe ni boshnjak. Ata tanë kohën m'kanë vëzhgu se kah po shkoj, me kond po rri, çka po flas e tjera e tjera.

Kto peripetitë, se osht' perioda ni vjeçare atëherë. Konfliktin e kom pasë edhe me eprorin, jo për fajin tim po për fajin e tina. Na majti, ishte 29 nëndori na majti ligjerata tha se, "Në Jugosllavi", tha, "jetojnë dikund 300 e 50 mijë deri 400 mijë banorë, e Shqipnia ka interes m'u interesu për këta, për këtë minoritet që osht' për këtë kombësi", edhe tha, "s'kemi", tha, "marrëdhënie diplomatike me Shqipërijen". Unë e kisha përpara borbën. Në borbë në mes shkrujke aty që, 'Ambasada', Xhavit Nimani ish shku në Ambasadën e Shqipërijës se ka marrëdhënie diplomatike. Kishin fillu...

Po thotë numrin e... edhe pa një pa dy thotë, "Hajde Abazi". Tash ishte problemi jem se si me reagu. Thashë, "Sa i përket aspektit diplomatik, marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë janë të krijuar qe dy-tri vjet. Sa i përket numrit të shqiptarëve me regjistrimin e '71-shes janë dy milion e 300 mijë banor", e hudha poshtë atë 400 mishin e tina edhe thashë, "po shkrun në kalendar, jo që e kom majtë evidencë unë këta". Ai ka thanë, "Pesë minuta pushim", edhe ka ikën. Atëherë m'u vërsulën qita dy që m'përcjellshin edhe po thojnë, "Ka ti i more kto informata?" "Qy bre", thashë, "lexone borbën e qe borba po shkrun, qe edhe n'kalendar", thashë, "numri i banorëve shqiptarë në Jugosllavi. Unë s'i kom shpikë kto".

Mirëpo prej atij momentit isha në përcjelle të shumta. Këta tentun me ma marrë maskën, me ma vjedhë e tani me më akuzu. Po tanë kohën kom qenë pak a shumë t'u e ditë se çka m'pret e qysh i kanë pritë tjetër. Gjithmonë jom kujdesë që t'jom afër kolegëve, mos m'u nda nga turma e ushtarëve tjerë, a po kupton? Kështu që edhe ajo periodë... katër ditë m'kanë nalë mas afatit ushtarak vetëm e vetëm mos po revoltohna unë që t'më çojnë në burg. Kështu që edhe ajo peripeti kaloj se isha i vetëdijshëm për çka kom qenë n'burg edhe kërkesat e mija ishin, jo veç t'mijat po popullit tonë, që t'jetë i barabartë dhe i lirë në atë Jugosllavijen që ishte atëherë.

Pjesa e Katërt

Hasan Abazi: Ti ma bane pytjen rreth aktivitetit të... peripetitë tjera i kom pasën gjatë demonstratave '81-shit. Kom qenë në biseda informative. Në Ferizaj në biseda informative duke më akuzu, duke na akuzu, jo vetëm mu po ne gjeneratën '68-tes se 'Ne jem vazhdimësi që i kemi organizu edhe këta të '81-shes'. Kom qenën disa herë në bisedë informative se ti e din ku osht' Ahmet Qiriqi, ishte një prej organizatorëve të '81 dhe tjetër.

Unë, u mbrojsha se, 'Nuk kemi na gisht të '68-tes. Por sikur t'ish kry në '68-ten republika nuk ish ardhën '81-sha në demostrim. Po atëherë nuk osht' kry, e gjenerata që atëherë i ka pasë nanë-dhetë vjet tash i ka bo 20 vjet dhe ajo don me kërkuen sikur që kemi kërkua na. Se osht' ni rrugë që nuk nalet për t'drejtat tona'. Kështu që mas ni peripetie tri ditore, atëherë më lirunën dhe m'thanë që, 'Ki kujdes se na jena t'u t'vëzhgu ty'. Kjo ka vazhdu deri në vitet e '90-ta kur veç u prish ish Jugosllavia. Domethonë fillunën largimi i punëtorëve nga puna, marrja e autonomisë nga pushteti i atëhershëm...

Anita Susuri: A ju kanë largu edhe juve në të '80-tat?

Hasan Abazi: Na kanë largu edhe mu.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë kjo?

Hasan Abazi: Po unë isha n'pushim vjetor dhe atëherë e bonëm organizimin sindikal edhe në ndërmarrje. Unë isha zëvendës kryetar. Kryetar ish Ismet Sadiku edhe erdha në Prishtinë. Këtu ku u bo organizimi i bashkimit të sindikatave edhe niherit e bonëm edhe themelimin ku i kemi sot 33 vjetorin e themelimit të Sindikatës së Pavarur të Metalistve të Kosovës. I morëm qëndrimet se si me veprue në rast të afrimit të nënshkrimit me njoftë pushtetin e Serbisë. U ktheva t'ia komunikoj shokve në ndërmarrje, papritmas erdhën dy serb qaty që punojshin.

Ma ofrunën ni vendim me nënshkru edhe pse s'kishin të drejtë atë me ma bo. Thashë, "Unë jom n'pushim", tha, "Ti duhesh me nënshkru këta edhe ma nuk je n'punë". Faktikisht nga ai moment ma s'kisha t'hi edhe në fabrikë. Kështu që dikun në dhjetor të 1990-tes më kanë largu nga puna mu edhe të gjithë stafin udhëheqës. E më vonë edhe ni numër t'madh të punëtorëve të cilët nga dinjiteti i tyre personal nuk e kanë nënshkrue vendimin që me njoftën pushtetin e atëhershëm të Serbijes.

Kështu që vazhdova aktivitetin sindikal në Prishtinë me kolegët të ndjerin Agim Hajrizin, Hamëz Jasharin e shoktë e tjerë në Sindikaten e Pavarur dhe Bashkimin e Sinvikatave të Kosovës. Ktë e kom fillu në vitin 1990 dhe po e vazhdoj deri në 2023-ten (qeshë). Domethonë 33 vjet aktivitet në sindikatë. Të cilën nga viti '97 e udhëheqi edhe si kryetar të degës të metalistëve të Kosovës, sektori i industrisë.

Gjatë viteve 1990 deri në vitin 2000 krye këput organizimi jonë ka qenën me majtë të informum punëtorinë. Aty ku kemi pasë mundësi të ndikojmë që t'mos dalin punëtortë tanë prej punës ku kanë kriju kushtet. Kemi thanë që, për arsye se e dishim që çashtja jonë nuk zgjidhet për ni kohë t'shkurtë po për ni kohë t'gjatë. Kemi lobu në botë me anë të shkresave, me anë të takimeve për t'drejtat e punëtorëve, t'drejtat e njeriut, shkeljen e tyre nga ana e Millosheviçit.

Kemi marrë pjesë në shumë kongrese, shumë koferenca, seminare, në takime ndërkombëtare si në Bruksel. Kemi shkru Parlamentit European për, e kemi njoftu për të drejtat tona, shkeljet që janë bo, largimin e punëtorëve nga banesa e tyre pa të drejtë, e tjera, e tjera. Të gjitha kto. Besa edhe vrasjen e Hamëz Jasharit, se e kemi pasë anëtarë të kryesisë na Hamzën edhe pse Ademin e kemi pasë si anëtarë kshu po Hamzën e kemi pasë anëtarë të përbashkët.

1990-ten me 24 mars si aktivist sindikal e politik e tjerë, e kanë vra edhe Agim Hajrizin kolegun të cilin fotografinë këtu po e mbaj në këtë zyre. Krahas aktivitetit sindikal të cilin e elaburova n'pika t'shkurta, kam pasë edhe aktivitet politik. Në vitin 1989 u themelun partitë politike dhe sindikatat në ish

Jugosllavi u regjistruan. Në mesin e tyre edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Kështu që unë u bënë anëtarë të Lidhjes Demokratike, dega në Ferizaj.

Mirëpo për shkak se i dënuan politik në atë kohë ishte pak në hezitim që të burgosurit politik mos të anëtarësohen, mos të marrin funksione në parti që pushteti i atëhershëm mos po e ngjyrosë me ndonjë peripeci politike tjetër. Kështu që unë e kom ndihmë në përgatitjen e formularëve në '89-'90 derisa jom largu nga puna në fabrikë edhe ia kom çu që njerëzit të deklarohen, të mushin atë formular. Kam qenë aktiv në atë drejtim po në prapavijë jo edhe drejtpërdrejt në kryesinë e parë.

Në kryesi kom hy me 1993-tën. Ndërsa në zgjedhjet e para për Parlamentin e Kosovës në 1992 jom propozue kandidat për zonën e parë në Ferizaj dhe jam zgjedhë deputet i Parlamentit të Kosovës. Me zgjedhjen e deputet i Parlamentit të Kosovës ma nuk e kom mendu që do t'j'om i gjallë në atë kohë se nuk ka pritë fotelja, nuk t'kanë pritë kushte, nuk t'kanë pritë beneficet. Po t'ka pritë burgosja ose edhe likfidimi, se kemi qenë si pushtet paralel në kohën e Millosheviçit.

Kështu që në 1993-tën, u zgjedha edhe anëtarë i kryesisë. Nga kryesia mora obligim ta udhëheqi komisionin e solidaritetit. Komisionin e solidaritetit e kom udhëheqë për katër vite, deri në '97-tën. Në '97-tën kom udhëheq komisionin e informimit. Në komision fort i randë në atë kohë për arsye se u dufke të informohet për lëvizjet ushtarake, policore, malltretimet e njerëzve, e aktivistëve e popullatës dhe krejt. Ku ishte edhe halë në sy e pushtetit të atëhershëm.

Në '98-tën prap më propozunën prap për me vazhdu, kandidat për Parlamentin e Kosovës dhe prap u zgjedha me shumicën e votave në krahasim me kandidatët e tjerë të partive tjera politike. Kështu që deri në vitin 2002 kom qenën edhe delegat i Kuvendit të Ferizajit edhe delegat i kuvendit në Lidhjen Demokratike në nivel qendror. Në vitin 2000 jom zgjedhë zëvendës kryetar i Lidhjes Demokratike, dega në Ferizaj.

Në zgjedhjet e para lokale në Ferizaj jom zgjedhë asamblesit i komunës së Ferizajit dhe kom udhëheqë grupin parlamentar të Lidhjes Demokratike në Ferizaj. Gjatë kohës '90-'99 përveç ktyne aktiviteteve të cilat i përmenda, kom themeluen edhe fondin e bursave për studentët e komunës së Ferizajit, që studiojnë në Universitetin e Prishtinës. Jo për studentët që studiojnë në Tiranë e në vende tjera po vetëm në Universitetin e Prishtinës.

Qëllimi ka qenë, qëllimi ka qenë që t'i ndihmohet edhe studentëve të varfër në Ferizaj po edhe niherit t'i ndihmohet Universitetit të Prishtinës që t'jeton hala. Ky ishte qëllimi jonë. Gjatë asaj kohe prej 1994 deri në 2002-tën faktikisht kemi financuen diku rreth 202 student. Kryetari i këshillit të fondit të bursave që është qujtë në atë kohë në Ferizaj, kam qenë unë. Për këtë kom qenë disa herë, rreth 14 herë kom qenë në biseda informative në pushtetin e atëhershëm. Sa që edhe m'kanë lidhë edhe për gilinderi, e m'kanë malltretu fizikisht e tjera, po i kom përballu e sot jom me juve këtu.

Anita Susuri: E lufta qysh ka qenë për juve?

Hasan Abazi: Para se me dalë deri te lufta, du t'ju tregoj që punën që e kom kry e kom ni ni lehtësim ose ni mburrje kur ka qenë fondi i bursave. Edhe pse unë mjetët e mija nuk i kom pasën po kem marrë nga qytetarët, nga bizneset e asaj kohe të cilët na kanë dhanën mjete dhe i kemi ndihmu studentët. Ku sot prej tyne ka mjek, ka profesor, ka ndoshta doktor, ka edhe të tjerë. Se osht' ni numër i madh i tyne. Për atë kohë osht', u kanë diçka e veçantë.

Kur m'kanë marrë n'bisedë informative policia më 09 prill 1998-ten, tha, "Kah ti paret?" Tha, "gjenerali jonë i ushtrisë tonë nuk i ka 40 euro rrogë ti 50 euro po ia jep studentëve. Kah kto pare? Amerika a kush t'i ka dhanë?" Thashë, "Jo more, qe e keni shtypin", bujku n'atë kohë. Se tanë aktivitetin e kom bo transparent. Thashë, "E keni ju shtypin edhe lexoni shtypin kush i ka, është kuvendi ai që i ka dhanë paret edhe janë studentët ata me emër të cilët kanë përfitu që e kanë gjendjen e randë ekonomike. Paret janë të qytetarëve për qytetar, për fmitë e vet".

Luftën e kam përjetuen vështirë, vështirë. Nuk kisha dashtë të hy fort se m'rrokin emocionet. Por, ditën e parë në mramje jom ndëgjju në telefon me Agim Hajrizin edhe m'ka thanë tri fjalë, "Cani, Cani, me sotën përfundoj Serbia në Kosovë". Mas 20 minutave këta e kanë likfidu. Të nesrit ma kanë likfiduen Ismet Ramadanin, shokun e ngushtë, shokun e shpirtit, e kanë masakru në Ferizaj. Ma vonë e kanë masakru shokun e gjeneratës '68-tes Afrim Loxha. Tash kto janë ato, a din, që thashë s'po hy. Mirëpo...

Anita Susuri: A keni qenë këtu?

Hasan Abazi: Kom qenë këtu deri me 03 qershor. Kom jetu prej ni familje n'familje tjetër, prej ni familje n'familjen tjetër kah tri ditë, tri netë e t'u u shpërngul kshtu te t'afërmit e mi. Unë të gjithë ktyne familjeve ju falënderoj. Nuk kom mundësi ndoshta tash t'ju kthej po vet liria e, që ka ardhë është diçka të cilën i shpërblehen edhe ata të cilët kanë ndihmue. Kështu që u detyrova m'u larguen për arsye se në vendin ku isha në Greme thanë se do t'vijne... i dajshin do bona atëherë thojshin për ushqim, e m'i evidentu kush janë prezent.

M'erdh lajmi prej do kolegëve që, 'Hasan duhesh m'u largu sa ma parë për arsye se si të identifikojnë që je ti këtu ka mundësi me masakru edhe qytetarët'. Kështu që u detyrova të largohna n'kamë nëpërmjet Maleve të Sharrit, të Lubotenit edhe të dal në Tetovë. Po shpejt nuk qëndrova gjatë atje, u kthynëm në Kosovën e lirë. Kështu që i vetëdijshëm për punën t'cilën e kom kry po nuk e kom ditë që këta janë t'u m'kërku për me m'likfidu ose edhe me m'burgosë.

Këta e kom marrë vesh tek vonë kur më burgosen te Dheu i Bardhë në 2012-ten. Aty më akuzojnë se shpihun i NATO-s, bashkëpunëtorë i NATO-s. Pikërisht për shkak të komisioneve dhe vepritarive tjera. Kur jom shku në gjykatë që më zunën, e kisha pasë historiatin tim qikaq të trashë, e gjykatësi veç e

shfletojke edhe thojke, “Çfarë historiati”. Që i kishin mbledhë krejt për aktivitetin sindikal e politik e solidar e të gjitha kto që janë.

Falë djalit, Haki Abazi, që pagujti 20 mijë euro dhe pesë mijë euro avokatit unë përkohësisht u lirova. Por sot ende jom nën hetime, në ndjekje të Serbisë kshtuqë nuk muj të dalë as në Maqedoni as në Mal të Zi, për shkak të kësaj aktakuze që m’u ka bo mue...

Anita Susuri: E qysh ju ka, qysh u sollën me juve kur ju kanë arrestu? A ka pasë ndonjë dallim prej kohës t’viteve...

Hasan Abazi: Jo nuk ka pasë, nuk ka pasë dallim prej kohës, e njejta, e njejta. Vetëm Burgu i Vrajës ishte burgu i ish komunistëve. Krejt në ciment. Prej atëherit sot unë kom peripetitë e gjunjve nga ftohti që ish aty. Falë dy shqiptarëve që ishin n’burg në dhomën ku isha unë, njëni prej Tërnovcit, se aty kishte pasën kriminel ordiner që kanë pasë mundësi që me m’likfidu mrena. Po falë tyne nuk guxojshin. Se njëni prej tyne kishte qenë i ashpër shumë e nuk kanë pasë, e nuk kanë pasë guxim. Tash n’bazë të deklaratave që ishin aty mrena, atij iu tutshin. Ka qenë nifar’ bokseri. Edhe pse ai ishte i akuzun për gjana tjera, a din, po megjithatë mu m’ka ndihmue.

Anita Susuri: Mirë zoti Hasan, nëse doni edhe diçka me shtu për fund nëse keni harru diçka me cekë?

Hasan Abazi: Unë në aktivitetin tim politik e kom kryen në Lidhjen Demokratike të Kosovës në ato kushte e rrethana të cilat kanë ekzistuar deri pas çlirimit. Peripetitë të cilat i kom pasën falënderoj babën edhe pse ai osht’ sot i ndjerë, i cili çdo herë m’ka përkrahë, familja, shoqja, fmitë që kanë pasë konsideratë. Vajzat e mija pak a shumë i kom detyru ta mbajnë gjallë jetën kulturore në Ferizaj.

Të dy vajzat e mija kanë këndu, kanë recitu në takimet për 28 nëndorin e festa tjera të cilat janë kanë. Në ni formë edhe unë kom mbjellë te to ni dashuri për çashtjen e atdheut edhe çashtjen... sa sot e kom edhe djalin deputet në vazhdimësi, osht’ i Parlamentit të Kosovës. Vazhdon aktivitetin ma tutje. Diçka të veçantë nuk kom, a din. Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët e mi, politik, humanitar, sindikal të gjithë nga tanë Kosova me t’cilët kom pasë ni bashkëpunim të mirë, të frytshëm me ta. Jemi mundu qaq sa kemi pasë mundësi edhe fuqi që të ndihmojnë për këtë gjeneratën edhe për shtetin tonë.

Anita Susuri: Faleminderit shumë edhe juve!

Hasan Abazi: Faleminderit edhe prej juve!